# DËSHMI ARKIVI

**A-472007**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | 35 vite më pas - Referendumi i 1991, për Republikën e Kosovës, sovrane dhe të pavarur! Ja fleta e votimit! |
| ADRESA | `https://www.syri.net/kosova/919361/referendumi-i-1991-per-republiken-e-kosoves-sovrane-dhe-te-pavarur-ja-fleta-e-votimit/` |
| BURIMI | syri.net |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 26 shtator 2026, 16:01:56 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 26 shtator 2026, 15:47:57 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `e552c94d47d50ba6ca0d174d6362b6aa08513a9c1252b2870985556fd08b865c` |
| TEKSTI | `3d4d2c1e781eb9d476dbe727b28522ac27997a957fcd4b2df7d764c8e7907948` |
| PAMJA | `6c99eb07d26f07835f7021d5cb96e74ee579038149e50478ea868c86b11d6310` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `0ff3aa387e7085847c93214e71b41b6d7a5991e569775a01c6b0db99dc1e6d9c` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `0334a22cab892da6eda5613cc640e69aa8a23a21585bae5896651df887e79535` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/0ff3aa387e7085847c93214e71b41b6d7a5991e569775a01c6b0db99dc1e6d9c`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



SONILA MEÇO
'Në emër të popullit të Kosovës', prokura e një kurthi



ÇIM PEKA
Nga Çim Peka-Tradhtia që s'e panë tu ardhë




# Referendumi i 1991, për Republikën e Kosovës, sovrane dhe të pavarur! Ja fleta e votimit!

17:47, 26/09/2026

Kryeministri i vendit, Albin Kurti, ka kujtuar 35-vjetorin e referendumit për pavarësinë e Kosovës nga Jugosllavia, të mbajtur nga data 26 deri më 30 shtator të vitit 1991. Në rrjetet sociale Kurti publikoi fletëvotimin e atij referendumi që përfaqëson një ngjarje me rëndësi historike.

> *"Përmes këtij referendumi, populli i Kosovës ia bëri me dije Evropës dhe botës demokratike, aspiratën e tij politike që Kosova të jetë një shtet i pavarur dhe sovran si dhe i barabartë me shtetet e tjera demokratike. Kjo nënkuptonte që Kosova duhej çliruar e shkëputur nga Jugosllavia dhe Serbia pushtuese. Kjo aspiratë u realizua tetë vite më pas, në qershor të vitit 1999, pas një dekade të përshkuar nga mosbindja civile dhe rezistenca paqësore, pasuar nga rezistenca e armatosur dhe kulmuar nga lufta e drejtë çlirimtare e popullit tonë, me Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës si bartëse e saj, e ndihmuar më pas nga shtetet aleate të NATO-s, drejtuar nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës" shkruan Kurti*

*Kështu dukej një fletëvotim i referendumit të vitit 1991, për Republikën e Kosovës, sovrane dhe të pavarur!*

Këto ditë, po bëhen 35 vite prej kur nga data 26 deri më 30 shtator të vitit 1991, në tërë Kosovën u mbajt një referendum demokratik për pavarësimin e Republikës së Kosovës nga Jugosllavia, si shtet sovran dhe i pavarur. Kjo republikë ishte shpallur një vit më parë më 1990, me Deklaratën Kushtetuese të miratuar më 2 korrik në Prishtinë dhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës të miratuar më 7 shtator në Kaçanik.

Nga 1 051 357 qytetarë me të drejtë vote, 914 802 prej tyre apo 87.01 % morën pjesë në referendum, kurse 12.9 % apo 136 555 nuk dolën në referendum. Nga këto vota, 913 705 qytetarë votuan për "Po" kurse vetëm 164 votuan kundër me "Jo", teksa 933 fletëvotime rezultuan të pavlefshme. Kështu, gjithsej 99.87 % e qytetarëve votuan për Republikën e Kosovës shtet sovran dhe i pavarur, vetëm dy

## më të lexuarat

Në gjithë Kosovën sot protestohet kundër vendimit ndaj ish-krerëve të UÇK-së

Zuckerberg zbulon orën e tij: Zgjedhja e veçantë lidhet me orëndreqësin nga Kosova, Rexhep Rexhepi

Ambasada amerikane: Mezi presim të punojmë me Qeverinë dhe Kuvendin e ri të Kosovës

Gërvalla: Çështja e Speciales është betejë ligjore, jo betejë deklaratash

Referendumi i 1991, për Republikën e Kosovës, sovrane dhe të pavarur! Ja fleta e votimit!

Vuçiçi akuzon Rashqin se me mbështetjen për Listën Studentore 'po zbaton urdhrat' e Kurtit

Nisma për ndryshimin e ligjit të Specialeve është dërguar për mendim në

vite pasi Serbia me dhunë ia kishte suprimuar autonominë Kosovës si subjekt kushtetues e njësi konstituive e federatës së ish Jugosllavisë.

Referendumi i shtatorit 1991 për Republikën e Kosovës shtet sovran dhe i pavarur, përfaqëson një ngjarje me rëndësi historike, meqë ishte e para herë që populli i Kosovës po deklarohej lirshëm duke shprehur vullnetin e tij për vetëvendosje. Përmes këtij referendumi, populli i Kosovës ia bëri me dije Evropës dhe botës demokratike, aspiratën e tij politike që Kosova të jetë një shtet i pavarur dhe sovran si dhe i barabartë me shtetet e tjera demokratike. Kjo nënkuptonte që Kosova duhej çliruar e shkëputur nga Jugosllavia dhe Serbia pushtuese. Kjo aspiratë u realizua tetë vite më pas, në qershor të vitit 1999, pas një dekade të përshkuar nga mosbindja civile dhe rezistenca paqësore, pasuar nga rezistenca e armatosur dhe kulmuar nga lufta e drejtë çlirimtare e popullit tonë, me Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës si bartëse e saj, e ndihmuar më pas nga shtetet aleate të NATO-s, drejtuar nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Andaj për mot, si sot, i kujtojmë zhvillimet dhe ngjarjet që e shkëputën Kosovën nga epoka e shtypjes dhe dhunës shtetërore, nga eksploatimi ekonomik dhe diskriminimi politik, nga spastrimi etnik dhe gjeonicidi, të gjitha këto të ushtruara nga regjimi i Serbisë ndër dekada të tëra.

Me mirënjohje, nderim e respekt për të gjitha gjeneratat e aktivistëve që e mirëmbajtën përpjekjen dhe angazhimin e popullit të Kosovës për liri e bashkim, pavarësi e demokraci, për shtet dhe përparim!

© SYRI.net

Lexo edhe:


Gërvalla: Çështja e Speciales është betejë ligjore, jo betejë deklaratash


Rama zhgënjen mediat në Prishtinë: Kosova pa zë në OKB, asnjë fjalë për UÇK-në


10 netë protesta kundër dënimit të ish-udhëheqësve të UÇK-së

## Komentet

Qeveri

Protestë para OKB-së në New York kundër vendimit ndaj ish-krerëve të UÇK-së

Mali i Zi ndalon ngarkesën me mish të skaduar të destinuar për Kosovën

Shto koment

Emri

Shkruani komentin tuaj

Posto

## TË NGJASHME

Presidenti/ Hamza: Do i përshtatim qëndrimet pasi jemi në rrethana të reja, i gatshëm për takime

Kuvendi mban seancë të hënën, në rend dite Deklarata për aktgjykimin e Speciales

Deklarata kundër Speciales, Haxhiu: Do të kontribuojmë në draftimin e saj

Kurti: Zgjedhjet e reja janë të panevojshme e të kushtueshme

Mali i Zi ndalon ngarkesën me mish të skaduar të destinuar për Kosovën

Nisma për ndryshimin e ligjit të Speciales është dërguar për mendim në Qeveri



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do ti gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojmë të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Stafi i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.